



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001879/12

Tiranë ____/____/2022

Lënda: *Rekomandim për analizimin e rastit të punonjësve të Policisë Bashkiake
Tiranë të cilët kanë kryer veprime me shtetasin H.Sh. në datën 21.05.2020.*

**POLICISË BASHKIAKE
KRYEINSPEKTORIT
Tiranë**

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË
Tiranë**

Të nderuar,

Me shkresën nr. K2/I22-9 prot., datë 06.11.2021 ju kemi vënë në dijeni se institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me nismën e vet rastin e bërë publik në media në datën 25.05.2020, një video me titull: “Policia Bashkiake dhuron të riun rom që mbledh kanaçe”, e publikuar nga kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, Belind Këlliçi. Sipas mediave, në videon e publikuar nga Këlliçi shihet që punonjës të Policisë Bashkiake kanë kapur një qytetar, i cili po mbledhte mbetje të riciklueshme dhe në momentin që tentojnë ta fusin në automjet, e dhunojnë atë.

Nga pamjet e shfaqura në këtë video duket se nga automjeti i Policisë Bashkiake zbret apo tenton të ikë një person dhe pasi ai del nga makina por i kapur prej krahu nga një punonjës policie, pengohet në një biçikletë/karrocë që ishte aty pranë dhe rrëzohet në trotuar. Nga pamjet si dhe objektet e mjetet që janë pranë vendit të ngjarjes, kuptohet se i riu duhet të ketë qënë duke mbledhur mbetje të riciklueshme pranë koshave të grumbullimit të mbetjeve urbane, sepse aty pranë përveç tre koshave për grumbullimin e mbetjeve urbane, ndodhet edhe një biçikletë/karrocë e mbushur me mbetje të riciklueshme. Gjithashtu, dëgjohet që i riu bërtet ndoshta me qëllim që policët ta lënë të lirë.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 16970/1 prot., datë 17.06.2020, ndërmjet të tjerave na informuat se, shërbimet e Policisë Bashkiake, në datën 21.05.2020, rreth orës 22:30, kanë qenë duke patrulluar në rrugën “Tre Dëshmorët”, Tiranë, ku kanë konstatuar një person i cili po mblidhte mbetje të riciklueshme në kontenierët e Bashkisë Tiranë, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, sipas të cilit, *të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore*. Sipas përgjigjes tuaj, ky veprim është në kundërshtim edhe me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Tiranë “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”, respektivisht nenin 5, pikat 28 dhe 29, ku përcaktohet statusi i pronësisë së këtyre mbetjeve si dhe domosdoshmëria e mbrojtjes së shëndetit publik nga keqpërdorimi i tyre. Gjithashtu në nenin 50, pika 168 të kësaj rregulloreje parashikohet se, *është e ndaluar nga qytetarët dhe çdo person i paautorizuar të kryejë çdo lloj seleksionimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, kërkim apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenier ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final*.

Përveç sa më sipër, ju na informuat se gjatë komunikimit me personin në fjalë, shërbimet e Policisë Bashkiake e kanë pasur të pamundur ushtrimin e detyrës, ky shtetas ishte nën efektin e alkoolit dhe nuk pranonte të identifikohet. Në këto momente janë afruar disa qytetarë që po vështirësonin akoma më shumë kryerjen e detyrës nga punonjësit e Policisë Bashkiake. Duke parë gjendjen e rënduar, si pasojë e konsumimit të alkoolit, personi është ulur në ndenjësën mbrapa të makinës, për t’u qetësuar. Kur personit i është kërkuar përsëri identifikimi, ai është frikësuar dhe ka tentuar të largohej, ku gjatë daljes nga makina është penguar tek biçikleta e tij. Duke parë situatën e rënduar psikologjike të personit, ndaj tij është bërë këshillimi me qëllim që të mos e përsërisë më shkeljen e bërë, në të kundërt do të merren masa sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërkohë na informuat se shërbimet e Policisë Bashkiake nuk kanë ushtruar dhunë ndaj shtetasit në fjalë që sipas jush është i paidentifikuar.

Për ta plotësuar hetimin administrativ të këtij rasti nga ana jonë u thirrën dhe pyetën të dy punonjësit e Policisë Bashkiake, Ergys Shtishi dhe Renato Pepa, të cilët kishin konstatuar shtetasin H.Sh. duke mbledhur mbetje të riciklueshme në kontenierët e mbetjeve urbane. Ata ndërmjet të tjerave deklaruan se për shkak të situatës së krijuar në mbrëmjen e datës 25.05.2020 **nuk kishin kryer procedurat ligjore** për shoqërimin e personit në Komisariatin e Policisë në zonës dhe bllokimin e karrocës/biçikletës dhe të mbetjeve urbane.

Përveç videos së përmendur më sipër, në një video tjetër të publikuar në media në datën 27.05.2020 është dhënë një intervistë e bërë me shtetasin rom H.Sh. me të cilin ka ndodhur ngjarja në fjalë. Gjatë intervistës, ai ka deklaruar se ka qenë së bashku me bashkëshorten duke mbledhur mbetje të riciklueshme dhe se është dhunuar nga punonjësit e Policisë Bashkiake dhe se për këtë veprim të kundërligjshëm të tyre ai ka bërë kallëzim në Komisariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, në territorin e të cilit ka ndodhur kjo ngjarje.

Për të sqaruar këtë fakt, ne i kërkuam shpjegime Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë nëse ky shtetas i komunitetit rom ka bërë kallëzim në këtë organ ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake për dhunën e ushtruar ndaj tij dhe nëse po, çfarë veprimesh procedurale janë kryer lidhur me kallëzimin e bërë.

Komisariati i Policisë nr. 6 Tiranë me shkresën nr. 4547/1 prot., datë 07.10.2020, na informoi se në datën 26.05.2020 është paraqitur shtetasi H.Sh., të cilit i është marrë kallëzimi dhe është pajisur me vendim për kryerjen e ekzaminimit mjekoligjor. Materialet e administruara i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr. 3897 prot., datë 29.05.2020.

Në vijim të ndjekjes së këtij rasti i kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dërgimin e një informacioni lidhur me veprimet procedurale që janë kryer nga ky organ për kallëzimin e shtetasit H.Sh., i cili është referuar nga Komisarati i Policisë nr. 6 Tiranë me shkresën e cituar më sipër.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr. 3228/1 prot., datë 10.03.2022, na vuri në dijeni se në këtë organ është regjistruar kallëzimi penal nr. 6569, i vitit 2020, për veprën penale dëmtime të tjera me dashje, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, referuar nga Komisarati i Policisë nr. 6 Tiranë, për të cilin është vendosur mosfillimi në datën 16.06.2020. Bashkëlidhur me përgjigjen organi i prokurorisë na dërgoi edhe kopjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal si dhe të vendimit penal nr. 1434 akti, datë 07.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për mos pranimin e ankimit të shtetasit H.Sh. kundër vendimit të mos fillimit të procedimit penal nr. 6569 të vitit 2020.

Nga përmbajtja e dy vendimeve të cituara më sipër rezulton se nga policia gjyqësore pasi është marrë kallëzimi penal shtetasit H.Sh., i është dhënë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor. Nga akti i ekspertimit mjekoligjor nr. 480, datë 10.06.2020, kryer nga ekspertja mjekoligjore Vjola Fera është arritur në konkluzionin se: *“Në trupin e shtetasit H.Sh. nuk u konstatuan dëmtime trupore”*. Nga analizimi i provave të administruara gjatë fazës së verifikimeve organi i prokurorisë ka arritur në konkluzionin se ka shkaqe ligjore që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale, pasi në rastin konkret fakti i kallëzuar nuk ekziston. Në përfundim organi i prokurorisë me vendimin e datës 15.06.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 6569, të vitit 2020.

Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit H.Sh., i cili ka bërë ankesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj vendimit të datës 15.06.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 6569, të vitit 2020. Gjykata me vendimin nr. 1434 Regj. Them., datë 07.10.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit H.Sh. për prishjen e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për mosfillimin e procedimit penal nr. 6569, të vitit 2020 dhe

vijimin e hetimeve. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 06.11.2020, pasi nuk është ankimuar.

Sqarojmë se referuar akteve normative në fuqi, vendimet e organeve të prokurorisë dhe gjykatës janë jashtë juridiksionit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe se ndaj tyre palët në proces kanë të drejtë që të bëjnë ankim në gjykatat më të larta në hierarki. Në këtë kuadër, në rastin konkret objekt i hetimit tonë administrativ nuk është analiza dhe baza ligjore e vendimeve të prokurorisë e gjykatës të marra lidhur me kallëzimin e bërë nga shtetasi H.Sh., por do të ndalemi tek një fenomen që në vlerësimin tonë është i përsëritur në veprimtarinë e Policisë Bashkiake. Ky fenomen shqetësues është konstatuar dhe bërë prezent nga institucioni i Avokatit të Popullit në disa raste të trajtuara edhe më parë dhe lidhet me mos kryerjen e detyrës konform akteve normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake. Konkretisht evidentohet mos kryerje e disa procedurave dhe përpilimi i dokumentacionit në rastet kur nga punonjësit e Policisë Bashkiake konstatohen apo kapen shtetas duke shkelur aktet normative në fuqi, si mbledhje dhe marrje e mbetjeve të riciklueshme në kontenierët e grumbullimit të mbetjeve urbane, tregtim produktesh në vendet e ndaluara, etj.

Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme me rastin në fjalë, ju na keni informuar se, meqënëse sipas nenit 2 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të gjitha llojet e mbeturinave, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore, “marrja” e tyre nga kontenierët është vepër penale dhe konkretisht “Vjedhje”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, pavarësisht vlerës që kanë.

Duke iu referuar nenit 10 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” ku parashikohet se: *“Kur gjatë kryerjes së shërbimit konstatohen elemente të veprave penale, punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale marrin masa për shoqërimin e autorëve në komisariatit e policisë, ruajnë vendin e ngjarjes, fiksojnë dëshmitarët dhe ruajnë provat deri në ardhjen e policisë gjyqësore”*, konstatojmë se sjellja e dy punonjësve të Policisë Bashkiake Ergys Shtishi dhe Renato Pepa nuk është në përputhje me ligjin e referuar më sipër, si dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale *për ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimit e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave deri në ardhjen e policisë gjyqësore, etj.* Ata nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të citur më lart për të marrë masa për shoqërimin e autorëve në komisariatit e policisë, ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimit e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave deri në ardhjen e policisë gjyqësore, sekuestrimin e karrocës/biçikletës dhe të mbetjeve urbane.

Argumentimi i bërë nga ana juaj në përgjigjen e dërguar institucionit tonë, se shërbimet e Policisë Bashkiake e kanë pasur të pamundur ushtrimin e detyrës, është i pabazuar në ligj. Çmujmë se është i papranueshëm justifikimi se personi në fjalë ishte nën efektin e alkoolit dhe nuk pranonte të identifikohet, se në këto momente janë afruar disa qytetarë që po vështirësonin akoma më shumë kryerjen e detyrës etj. Po ashtu, i pajustificuar është edhe fakti se punonjësit e Policisë Bashkiake duke parë gjendjen psikologjike të rënduar të

personit, si pasojë e konsumimit të alkoolit, e kanë këshilluar me qëllim që të mos e përsërisë më shkeljen e bërë, në të kundërt do të merren masa sipas legjislacionit në fuqi.

Ky qëndrim i punonjësve të Policisë Bashkiake nuk gjen mbështetje as edhe në “Rregulloren e brendshme "tip" të Policisë Bashkiake e të Komunës”, miratuar me Urdhrin e përbashkët nr.1 datë 17.04.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe të Ministrit të Rendit Publik, neni 14/9, ku përcaktohet se:

“Punonjësit e Policisë Bashkiake e të Komunës kanë atributet e oficerit e të agjentit të policisë gjyqësore vetëm në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, të ligjit përkatës e sipas udhëzimit nga organet kompetente”.

Duke iu referuar akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake, nëse veprimet e punonjësve janë kryer në përputhje me ligjin sa i përket rastit objekt hetimi administrativ, vlerësojmë se:

1. Në bazë të nenit 8/2 e 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake dhe të Komunës”, i ndryshuar, dhe neni 13, pikat 2 e 5 të “Rregulloren së Brendshme "tip" të Policisë Bashkiake e të Komunës”, miratuar me Urdhrin e përbashkët nr.1 datë 17.04.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe të Ministrit të Rendit Publik, Policia Bashkiake ka për detyrë:

- a - ruajtjen e pasurisë së bashkisë dhe atyre që administrohen prej saj;
- b - të konstatojë e parandalojë ndotjet në mjedis.

2. Në bazë të nenit 2 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe neni 5, pika 29 të Rregullores së Bashkisë Tiranë “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”, miratuar me Vendimin nr.1, datë 05.02.2007, të Këshillit Bashkiak, *të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre:*

- a - janë pronë shtetërore;
- b - ndalohet seleksionimi e marrja e tyre nga qytetarët dhe nga çdo person i paautorizuar, pasi ato hidhen në kontenierë.

3. Sipas nenit 11, pika 1, gërma “m”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak (VKB) Tiranë nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionet që vendosen për to në territorin e Bashkisë Tiranë për aq sa nuk përbën vepër penale, **përbën kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit** “Kryerja e seleksionimit manual, kërkimi apo marrja e mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, etj. nga persona të paautorizuar”.

Theksojmë se, në kundërshtim me qëndrimin dhe vlerësimin tuaj të cituar më sipër, ne çmojmë se, “Kryerja e seleksionimit manual, kërkimi apo marrja e mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, etj. nga persona të paautorizuar”, **përbën kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit dhe jo vepër penale “Vjedhje”,** parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

4. Sipas nenit 2, pika 1 dhe neni 31 të VKB Tiranë nr. 156, Policia Bashkiake është njëra prej strukturave konstatuese të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në këtë akt dhe zbatuese e tij.

Më konkretisht, sipas nenit 21, pikat 1 e 2 të VKB Tiranë:

- *Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjitha kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si dhe të çdo shkelje tjetër të përcaktuar nga KB i Tiranës apo Kryetari i Bashkisë së Tiranës;*
- *Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.*

Sipas nenit 27 të VKB Tiranë nr. 156, kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim apo mosveprim i një personi fizik ose juridik, përbën kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

Ndërsa, sipas nenit 14 të VKB Tiranë, përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.

Përveç sa më sipër, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për parandalimin e ndotjes së mjedisit, në fushën e mbledhjeve dhe përpunimit të mbetjeve të riciklueshme, etj., Bashkia Tiranë së bashku me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorinë Rajonale të Hetimit Tatimor Tiranë, Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Tiranë dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, më datë 31.01.2017, kanë nënshkruar Planin e Përbashkët “Për parandalimin e ndotjes së mjedisit, identifikimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm, të ushtruar nga individë apo subjekte private, në fushën e mbledhjes, përpunimit të materialeve të riciklueshme, në territorin e Bashkisë Tiranë”.

Referuar përcaktimeve të bëra në këtë Plan të Përbashkët, Policia Bashkiake Tiranë, është përcaktuar përgjegjëse veç të tjerash të organizojë kontrole të territorit, për identifikimin, kapjen në flagrancë të personave, që dëmtojnë, apo vjedhin kontenierët, mbetjet e riciklueshme që ndodhen në to, duke marrë masa administrative me gjobë, bllokime të materialeve, si dhe për rastet e përsëritura, të bëhen kallëzime penale, pranë Komisariateve të Policisë, për veprat penale të konstatuara. Gjithashtu sipas këtij plani, Policia Bashkiake ka detyrimin të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë Nr. 1, Nr. 2, të Punëtorëve të Qytetit, Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtorinë e Pastrimit të qytetit, struktura të cilat do të vendosin në dispozicion mjete e punonjës, për transportimin në landfill të materialeve të riciklueshme që do të bllokohen.

Ndërkohë, vlen të përmendet fakti se në Urdhrin nr. 22864, datë 08.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për marrjen e masave dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, nga individë apo subjekte private që ushtrojnë aktivitet të paligjshëm në fushën e mbledhjes, transportit dhe grumbullimit të mbeturinave apo materialeve të riciklueshme, që rrezikojnë shëndetin e njerëzve” parashikohet shprehimisht për: “1. Identifikimin dhe

kontrollin nga ana e Policisë Bashkiake të çdo individi apo subjekti privat që ushtron aktivitetin në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore, në fushën e mbledhjes, transportit dhe grumbullimit të mbeturinave, duke sjelle pasoja në ndotjen e mjedisit urban dhe shëndetit të njerëzve. 2. Policia Bashkiake merr masa të menjëherëshme për bllokimin dhe sekuestrimin e materialeve/mbetjeve të riciklueshme që sipas legjislacionit në fuqi përbëjnë pasuri shtetërore dhe që janë përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme nga persona fizikë dhe juridikë, të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur ligjor të lëshuar nga autoritetet përkatëse. 3. Policia Bashkiake, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, mbështet institucionet e tjera shtetërore, kur nga ana e tyre i kërkohet marrja e masave për ndërprerjen e paligjshmërisë ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbledhjes, transportit dhe grumbullimit të mbeturinave/materialeve të riciklueshme.....”.

*Nga analizimi i akteve normative të referuara më sipër rezulton se, **Policia Bashkiake Tiranë është përgjegjëse dhe ka kompetencë në kontrollin e territorit, si dhe ndalimin e personave që marrin mbetje urbane nga kontenerë, apo i transportojnë ato me mjete të ndryshme transporti. Por në të gjitha rastet ajo duhet të respektojë procedurat ligjore, duke i trajtuar këto raste si kundërvajtje administrative, të ndalojë shtetasit e kapur në flagrancë së bashku me mbetjet dhe mjetet e përdorura, të njoftojë Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë dhe të bashkëpunojë për të ndjekur procedurat administrative (sanksionet dhe aktet administrative) si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse, si përpilimi i aktit të konstatimit, procesverbalit për kundërvajtjen administrative, ku sanksionohet edhe masa e gjobës, si dhe procesverbalit të konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.***

Vlerësojmë të arsyeshme që të risjellim në vëmendje se, mos kryerja e veprimeve dhe procedurave të parashikuara në aktet normative ligjore e nënligjore të cituara më sipër nga punonjësit e Policisë Bashkiake, si për rastin në shqyrtim ashtu edhe në disa raste të tjera me këtë problematikë të ndjekura nga institucioni i Avokatit të Popullit, përbën mos përmbushje të detyrimeve ligjore. Ndërkohë çmojmë, se ky qëndrim lë shteg dhe krijon premisa për abuzime në detyrë nga punonjësit e policisë lidhur me fatin e mbetjeve të riciklueshme dhe të mjeteve të marra/bllokuara shtetasve në këto raste. Përpilimi/mbajtja e procesverbalit përkatës për çdo send të bllokuar apo sekuestruar nga punonjësit e strukturave shtetërore, qoftë ai edhe pa zot/pronar, është detyrim ligjor që duhet zbatuar në çdo rast dhe rrethanë. Në rastet kur njihet personi që i posedon ato, qoftë ai i ligjshëm ose jo, atij i jepet një kopje e procesverbalit të bllokimit apo sekuestrimit të tyre. Sjellim në vëmendje se aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake nuk parashikojnë të drejtën e punonjësve të këtij organi që të mos zbatojnë detyrimet ligjore në rastet ku personi në fjalë është në gjendje të dehur nga përdorimi i alkoolit, është në kushtet e efekteve të përdorimit të lëndëve narkotike apo kur në vendngjarje grumbullohen persona të tjerë që e bëjnë të vështirë ushtrimin e detyrës. Në këto raste, kur punonjësve të Policisë Bashkiake u krijohen vështirësi të tilla, për të bërë të mundur përmbushjen e detyrës, ata duhet të kërkojnë ndihmën e kolegëve, si dhe të strukturave të Policisë së Shtetit, por kurrësi të heqin dorë prej saj.

Mbajtja e procesverbaleve për bllokimin/sekuestrimin e sendeve qytetarëve në ato raste kur ata shkelin aktet normative ligjore e nënligjore në fuqi, përveç se përbën një detyrim

ligjor është një akt me vlerë juridike në favor të tyre. Për këtë arsye ata janë më të interesuar për përpilimin dhe posedimin e këtij akti me qëllim që sendet e bllokuara/sekuestruara të mos humbasin, vidhen apo dëmtohen, sikurse ka ndodhur në ndonjë rast, gjatë procesit të bllokimit/sekuestrimit, transportit ose gjatë periudhës së ruajtjes së tyre në ambientet e Policisë Bashkiake. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë lloj arsye që pronarët ose poseduesit e tyre të refuzojnë nënshkrimin e këtij dokumenti me vlerë juridike. Në vijim të kësaj logjike, çmujmë se ushtrimi i kontrollit nga strukturat drejtuese të Policisë Bashkiake ndaj punonjësve të tyre lidhur me korrektesën, saktësinë dhe cilësinë e përpilimit të këtij dokumenti është i domosdoshëm. Ky veprim do të sjell domosdoshmërisht rritjen e cilësisë së shërbimit të Policisë Bashkiake dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e besimit të publikut tek ky organ.

Në rastin në fjalë nga punonjësit e Policisë Bashkiake nuk është bërë as njoftimi/raportimi në organet e Policisë së Shtetit për shtetasin H.Sh., sikurse parashikohet në nenin 23/1 të Rregullores së cituar më sipër. Gjithashtu ne vlerësojmë se kryerja e veprimeve të tilla nga punonjësit e Policisë Bashkiake, të cilat janë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin, çenojnë rëndë autoritetin dhe besimin publik të Policisë Bashkiake.

Ndërkohë konstatojmë me shqetësim qëndrimin indiferent dhe mos reagimin e strukturave drejtuese të Policisë Bashkiake Tiranë ndaj shkeljeve ligjore të kryera me mosveprime nga punonjësit e këtij organi, Ergys Shtishi dhe Renato Pepa, në rastin e shtetasit H.Sh.. Ky qëndrim nuk i shërben aspak edukimit profesional të punonjësve të këtij organi si dhe përmirësimit të sjelljes dhe rritjes së performancës së tyre në përmbushjen e detyrave dhe misionit ligjor të kësaj strukture.

Nga ana tjetër, vlerësojmë se veprimet e kryera nga shtetasi H.Sh., ndoshta në padijeni të plotë nga ana e tij si veprime të kundërligjshme, janë kryer për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme të nevojshme për jetesën e familjes së tij. Në kushtet e varfërisë dhe të ardhurave të pakëta financiare, një nga aktivitetet me të cilin merren pjesëtarët e komunitetit rom është mbledhja e bidonave plastike, apo e kanaçeve në vendet e hedhjes së mbeturinave, për t'i shitur më pas në pikat përkatëse të grumbullimit të tyre. Ne çmujmë, se mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve të këtij komuniteti është një problem serioz, jo vetëm për ata vetë si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që ky komunitet të ndihet i diskriminuar, i pabarabartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Adresimi i problematikave e zgjidhjes së tyre për këtë komunitet kërkon koordinim ndër-institucional dhe duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar për mbrojtjen efektive të të drejtave të tij. Ndaj, nga institucionet shtetërore qendrorë dhe në nivel vendor kërkohet marrja e masave të qëndrueshme e mbështetëse me qëllim që ky komunitet të jetojë me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë. Lidhur me këtë problematikë evidente në vendin tonë, nga institucioni i Avokatit të Popullit u është rekomanduar në vijimësi strukturave shtetërore përfshirja në programet e formimit

profesional dhe punësimin e pjesëtarëve të komunitetit rom si dhe marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Ne çojmë se rasti në fjalë nuk duhet të kalonte pa u trajtuar, analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë konkrete ndaj dy punonjësve të policisë që i kanë kryer ato. Nga ana juaj duhet të ishte bërë verifikimi dhe analizimi i plotë i rrethanave dhe shkaqeve të ndodhjes së kësaj ngjarjeje, të nxirreshin përgjegjësitë konkrete dhe detyrat e nevojshme që do t'i shërbenin edukimit profesional të punonjësve të kësaj strukture, rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, si dhe të bëhej përgjithësimi i tij me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen. Për më tepër që evidentohet si problematikë e përsëritur dhe që nuk është adresuar pavarësisht se ka qenë objekt i rekomandimeve të mëparshme të institucionit të Avokatit të Popullit.

Përveç sa më sipër, konstatojmë se aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake sikurse janë, ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 për "Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës" dhe "Rregullorja e brendshme "tip" e Policisë Bashkiake e të Komunës", miratuar me Urdhrin e përbashkët nr.1 datë 17.04.2003 të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe të Ministrisë të Rendit Publik, nuk janë të përshtatura me aktet ligjorë të miratuar më pas dhe kanë nevojë për ndryshime e përmirësime. Procesi i përmirësimit duhet të bëhet jo vetëm nisur nga ana formale që ka të bëjë me ndryshimin e emërtimeve të njësive administrative territoriale në vendin tonë, por edhe nxitur nga fakti që aktet normative në fuqi në të cilat referohet veprimtaria e kësaj strukture të pushtetit vendor, sikurse mund të përmendim Kodin e Procedurës Penale, ligjin organik "Për Policinë e Shtetit", etj. kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme duke u përshtatur me situatën dinamike të ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike, të veprimtarisë më efektive ndaj kriminalitetit, por edhe në kuadër të procesit të integritetit të vendit tonë në strukturat e BE-së, ku përafrimi i legjislacionit është një nga prioritetet e këtij procesi.

Në aktet e reja normative të cilat duhet të jenë bashkëkohore dhe fryt i përvojave më të mira të strukturave homologe europiane, duke përcaktuar saktë objektin e veprimtarisë dhe detyrat funksionale, të vlerësohet shmangia e mbivendosjes së kompetencave të Policisë Bashkiake me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera shtetërore, mënyrat dhe format e bashkëpunimit me këto struktura, si dhe të përcaktohen kushtet dhe kriteret e punësimit në këtë organ me qëllim që t'u ofrojë një shërbim cilësor, dinjitoz dhe me etikë qytetarëve.

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në gjurmën "b" të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

REKOMANDOJMË :

1. Analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjëseve përkatëse ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake, Ergys Shtishi dhe Renato Pepa.
2. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë me qëllim njohjen dhe respektimin e akteve normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi gjatë kryerjes së detyrave dhe për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve.
3. Zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me veprimet që duhet të kryejnë punonjësit e Policisë Bashkiake në rastet kur konstatojnë persona që mbledhin mbetje të riciklueshme nga kontenierët e grumbullimit të tyre, si dhe mbajtjen, hartimin e procesverbalit në të gjitha rastet e bllokimit/sekuestrimit të sendeve dhe dhënien e kopjes së tij poseduesve të tyre.
4. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Policisë Bashkiake Tiranë me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.
5. Marrjen e masave të nevojshme me qëllim informimin e shtetasve duke vendosur tabela pranë kontenierëve të depozitimit të mbeturinave me mbishkrimin se ato janë pronë shtetërore dhe marrja e tyre, pavarësisht vlerës që kanë, është e dënueshme administrativisht.
6. Marrjen e masave të nevojshme duke nxitur strukturat kompetente për inicimin ligjor për të bërë të mundur ndryshimin dhe përmirësimin e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake, si të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” dhe të “Rregulloren e brendshme "tip" të Policisë Bashkiake e të Komunës”, miratuar me Urdhrin e përbashkët nr.1 datë 17.04.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe të Ministrit të Rendit Publik.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca